

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Revista franceze: Nga Thethi në Sarandë, nëntë mrekullitë e Shqipërisë që duhet t'i vizitoni të paktën një herë - Informohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/revista-franceze-nga-thethi-ne-sarande-nente-mrekullite-e-shqiperise-qe-duhet-ti-vizitoni-te-pakten-nje-here/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 08:10:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 08:02:17 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	463f5683b3f9fc0b1cbcb20a3b727a895e2fa1900ebdd0302ed601961ac0808b
TEKSTI	4cd9a15adbe8c0a005eaf24d28e8d148ec3caa419f7b34d66f9ba1f1a1d04c72
PAMJA	964f18234777c069ee8aa7c581ad1299952bb5689910acfb62c60c2896299c0b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	338788cafaed93621505000db9a728ddaa6771ffdf6c2d705388b4d33922690
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9887a58f034e5892caf63e36ccbe81dcf86c1b224001923b84c66783530d965e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/338788cafaed93621505000db9a728ddaa6771ffdf6c2d705388b4d33922690>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » Revista franceze: Nga Thethi në Sarandë, nëntë mrekullitë e Shqipërisë që duhet t'i vizitoni të paktën një herë

KRYESORE

Demo

Revista franceze: Nga Thethi në Sarandë, nëntë mrekullitë e Shqipërisë që duhet t'i vizitoni të paktën një herë

SEPTEMBER 15, 2026



Nga Alpet madhështore te ujërat e kristalta të Rivierës, Shqipëria po kthehet gjithnjë e më shumë në një destinacion të preferuar për turistët e huaj, shkruan Ambia Staley në botimin francez të revistës së njohur të udhëtimit "Quartz", e cila ka përzgjedhur nëntë vendet më të bukura të vendit, që sipas ekspertëve të turizmit meritojnë të zbulohen të paktën një herë.

Shumica e turistëve që planifikojnë një vizitë në Ballkan, ende zgjedhin të njëjtat destinacione të njohura bregdetare në Kroaci ose Mal të Zi. Shqipëria, e vendosur në jug të tyre, vazhdon të jetë më pak e përfshirë në itineraret tradicionale turistike, pavarësisht se ofron male spektakolare dhe një vijë bregdetare, që mund të rivalizojë shumë prej destinacioneve të Mesdheut.

Idea se Shqipëria është thjesht një version më pak i zhvilluar i fqinjëve të saj është tashmë e vjetruar. Industria turistike e vendit është zhvilluar me shpejtësi vitet e fundit, ndërsa çmimet për ushqimin dhe akomodimin mbeten përgjithësisht më të ulëta se në Kroaci apo Itali.

Sipas ekspertëve të turizmit, këto janë nëntë vendet më interesante për t'u vizituar në Shqipëri, nga Alpet në veri deri te Riviera në jug dhe qytetet historike në brendësi të vendit:

1. Thethi – Parajsa e alpinistëve

I vendosur në Alpet Shqiptare, Thethi është një nga destinacionet më spektakolare për adhuruesit e natyrës dhe të ecjeve në mal. Fshati është i rrethuar nga male dhe luginë që krijojnë një peizazh mbresëlënës. Dy prej aktiviteteve më të njohura janë ecjet drejt Syrit të Kaltër dhe shtegu nga Thethi drejt Valbonës.

Rruga drejt Syrit të Kaltër kalon përmes pyjeve dhe pranë përrënjeve, ndërsa shtegu Theth-Valbonë është shumë më sfidues. Ecja zgjat rreth 6 deri në 8 orë dhe kërkon përgatitje fizike. Thethi është destinacioni ideal për ata që janë të gatshëm të heqin dorë nga komoditetet e qytetit në këmbim të peizazheve të jashtëzakonshme malore.

2. Saranda – Qendra e jetës së natës në Rivierë

Saranda është një nga portat kryesore drejt Rivierës Shqiptare dhe një bazë e përshtatshme për të eksploruar jugun e vendit. Qyteti njihet për restaurantet, baret dhe jetën e natës, ndërsa afërsia me Ksamilin e bën të lehtë kombinimin e të dyja destinacioneve në një udhëtim.

Nga Saranda nisen edhe ekskursione me varkë drejt plazheve dhe gjireve, që janë të vështira për t'u arritur me makinë, mes tyre Kakomeja dhe Krorëza. Muajt maj, qershor dhe shtator ofrojnë një ekuilibër të mirë mes motit të ngrohtë, aktiviteteve turistike dhe numrit më të ulët të vizitorëve krahasuar me korrikun dhe gushtin. Në dimër, një pjesë e konsiderueshme e bizneseve turistike

Postimet e reja

Revista franceze: Nga Thethi në Sarandë, nënt...

SEPTEMBER 15, 2026

Rama publikon pamjet nga rruga e Komanit: Me...

SEPTEMBER 15, 2026

Plani për Porto Palermon, nga Muzeu i Luftës së...

SEPTEMBER 15, 2026

"AMG Food" e skandalit të salmonelës, pronare e...

SEPTEMBER 15, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 15, 2026

Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznese të paktën 1-vjeçare

Pas shpalljes së listës së fituesve të "Grant 2026" kanë nisur të dalin rastet ku...

Skema sesi IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që ju merr konsumatorëve me interesa mbi 30%!

Skandal me sallamin në dyqanet Conad, thirrje konsumatorëve ta kthejnë mbrapsht

6 milionë euro të Startup Albania: Përfituesit, qokat dhe "problematikët"

Na ndiq

Facebook

Instagram

mbyllen, ndaj Saranda është në maksimumin e saj gjatë sezonit të ngrohtë.

YouTube

TikTok

3. Porto Palermo – Një nga zonat më të qeta të Rivierës

Porto Palermo ofron një tjetër pamje të Rivierës Shqiptare, larg zhurmës dhe turmave të qendrave më të mëdha turistike. Në qendër të zonës ndodhet Kalaja e Porto Palermos, ndërsa pranë saj gjenden edhe gjurmë të historisë ushtarake të Shqipërisë, përfshirë një ish-bunker nëndetësesh.

Zona është veçanërisht e përshtatshme për kamping dhe eksplorim të gjireve të vegjël. Një mënyrë interesante për të zbuluar bregdetin është kajaku, i cili mundëson arritjen në gjire të izoluara, që nuk mund të vizitohen lehtë nga toka.

Porto Palermo është një zgjedhje e mirë për ata që duan të shijojnë Rivierën në një atmosferë më të qetë.

4. Korça – Histori, arkitekturë dhe atmosferë tradicionale

Korça është një nga qytetet shqiptare që dëshmon më mirë historinë dhe traditat urbane të vendit. Një prej atraksioneve kryesore është Pazari i Vjetër, me rrugët me kalldrëm, ndërtesat tradicionale dhe kafetë që krijojnë një atmosferë karakteristike.

Qyteti është i njohur edhe për kulturën e kafesë dhe për rakinë, pije tradicionale shqiptare. Ndryshe nga destinacionet e Rivierës, Korça nuk mbështetet te plazhet apo jeta e natës. Ajo tërheq vizitorët me arkitekturën, historinë, ushqimin dhe ritmin më të qetë të jetës.

5. Shkodra – Qyteti që zbulohet më mirë me biçikletë

Shkodra është e njohur për kulturën e saj të biçikletave. Për shumë banorë, biçikleta është një nga mënyrat kryesore për të lëvizur në qytet. Një udhëtim me biçikletë drejt Liqenit të Shkodrës, është një nga mënyrat më të mira për të përjetuar qytetin dhe rrethinat e tij. Mbi qytet ngrihet Kalaja e Rozafës, nga ku hapet një panoramë e gjerë mbi Shkodrën, liqenin dhe malet përreth. Shkodra ka gjithashtu, një rol të rëndësishëm si pikënisje për udhëtimet drejt Alpeve Shqiptare, përfshirë Thethin dhe Valbonën.

6. Gjirokastra – “Qyteti i gurtë”

E njohur si “Qyteti i Gurtë”, Gjirokastra është një nga qytetet historike më të rëndësishme të Shqipërisë dhe pjesë e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s. Çatitë dhe shtëpitë prej guri i japin qytetit pamjen e tij karakteristike. Në Gjirokastrë ndodhet edhe Kalaja e Gjirokastrës, ndërsa Pazari i Vjetër është një tjetër pikë kryesore turistike.

Një nga ndërtesat më interesante është Shtëpia e Zekatëve, e ndërtuar në fillim të shekullit XIX, e cila ofron një pamje nga afër, të mënyrës së jetesës së familjeve shqiptare të asaj periudhe. Gjirokastra është gjithashtu vendlindja e ish-diktatorit komunist Enver Hoxha, një fakt tjetër që i shtohet historisë shqiptare.

Për adhuruesit e gastronomisë, një prej specialiteteve tradicionale është qifqia, ndërsa një tjetër pjatë karakteristike është pashaqofte, një supë me bazë qumështi dhe qofte të vogla.

7. Dhërmiu – Për ata që kërkojnë plazhe dhe jetë nate

Dhërmiu është një nga destinacionet më të njohura të Rivierës Shqiptare për pushuesit, që kërkojnë plazhe, bare dhe atmosferë verore. Gjatë sezonit, muzika dhe festivalet janë pjesë e rëndësishme e jetës së zonës. Mes eventeve më të njohura është “Kala Festival”, që tërheq vizitorë të rinj nga vende të ndryshme.

Restorantet dhe baret buzë detit, janë një tjetër pjesë e rëndësishme e eksperiencës në Dhërmi. Për shkak të popullaritetit të madh gjatë korrikut dhe gushtit, rezervimi i hershëm i hotelit është veçanërisht i rëndësishëm.

8. Lini – një fshat i qetë buzë liqenit të Ohrit

Lini, në brigjet e Liqenit të Ohrit, ofron një version shumë më të qetë të Shqipërisë. Fshati ruan lidhjen me traditën e peshkimit dhe është një vend ku ritmi i jetës, është shumë më i ngadaltë se në qytetet turistike të Rivierës.

Në majë të kodrës ndodhet një sit arkeologjik me mozaikë të një bazilike paleokristiane të shekullit VI. Nga kodra hapet një pamje e gjerë mbi Liqenin e Ohrit dhe drejt Maqedonisë së Veriut. Lini është një zgjedhje ideale, për ata që duan të largohen për pak nga turmat dhe të zbulojnë një anë më të qetë të Shqipërisë.

9. Përmeti – Aventura përgjatë Vjosës

Përmeti ndodhet pranë lumit Vjosa dhe është një nga destinacionet më të rëndësishme të Shqipërisë për turizmin e aventurës. Rafting në Vjosë, është një nga aktivitetet më të njohura, por zona ofron gjithashtu mundësi për kamping, ecje dhe çiklizëm malor. Vjosa fitoi një status të veçantë në vitin 2023, kur u shpall park kombëtar i lumit të egër, duke u bërë parku i parë kombëtar i këtij lloji në Evropë.

Pranë Përmetit ndodhen edhe Banjat termale të Bënjës, pranë lumit të Lengaricës dhe një ure të periudhës osmane. Ujërat termale janë atraksionet më të njohura të zonës. Përmeti është një destinacion që bashkon natyrën, aventurën, historinë dhe traditat lokale, duke e bërë të vlefshëm një qëndrim disaditor.

Revista franceze Sarandë Thethi

SHARE.



RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radar.lajme@gmail.com

Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator

Një ditë me surpriza në dashuri: Horoskopi për të gjitha shenjat

Pak dramë, shumë ndjenja: Horoskopi i dashurisë për këtë javë

© Radar.al. dizenuar nga 1001solutions

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.